

Një udhëzues për... të shkruar 'Historinë tënde'

Jeta dhe përvojat tona janë një burim gjigant historik prej të cilave mund të zgjedhim e të shkruajmë. Thuhet se të gjithë e kanë një libër brenda vetes, dhe unë jam më se i sigurt se çdokush e ka një histori për të treguar. Jo vetëm kaq, por sa më shumë përvojë të kesh në jetë, aq më të bukura i ke edhe historitë! Prandaj, mos u mërzit nëse ke kohë pa prekur stilolaps me dorë. Historitë që ke do të jenë edhe më të mira prej përvojës së jetës që ke!

FILLO ME DIÇKA TË VOGËL

Kur mendon të shkruash një histori nga vetë jeta jote, fillo me diçka të vogël. Hidh në letër kujtimet që ke për atë ngjarje, dhe shih se çfarë historik do të dalin:

- Puthja jote e parë
- Një ditëlindje e paharrueshme – një festë që ke organizuar ti ose dikush tjetër ku ke qenë edhe ti
- Një kujtim i gjallë nga fëmijëria e hershme, përpara se të ishe 5 vjeç
- Lindja e një fëmije
- Dita jote e parë e punës
- Uniforma që ke veshur dikur, nëse ke mbajtur uniformë në punë apo në shkollë
- Një rast kur të kanë bërë të qeshësh me lot
- Një udhëtim i paharrueshëm.

SHKRIMET BIOGRAFIKE DHE LETËRSIA

Ki parasysh se si shkrimtar, mund të shfrytëzosh kujtimet dhe historitë e tua si në letërsi ashtu edhe në shkrime biografike. Nëse i pyet, shumica e shkrimtarëve do të të thonë se ata u kthehen vazhdimisht përvojave personale dhe marrin material prej tyre, edhe nëse nuk janë duke shkruar për veten e tyre ose për atë ngjarje në veçanti. Prandaj, të shkruash për jetën tënde është praktikë e mirë për të shkruar histori të sajara, sepse kështu ushtron kujtesën dhe e lidh veten me emocionet e tua.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT

Fotografitë, albumet, ditarët, kutitë me kujtime, etj janë diçka e shkëlqyer për të menduar për historinë e jetës tënde, ose për një seri historik. Një zonjë që njoh, gjatë gjithë jetës së saj ka mbajtur me besnikëri ditar dhe ka qenë e dhënë pas fotografisë. Tani ajo dëshiron që për nipat dhe mbesat të shkruajë historinë e jetës së saj dhe të shtojë në të edhe fotografitë. Kur të mbarojë, do të dalë një punë e shkëlqyer dhe ajo ka vërtet material të bollshëm për të shfrytëzuar.

Hidhu një sy albumeve, ditarëve, ndoshta edhe letrave, dhe shih se çfarë kujtimesh të sjellin. A nuk është e vërtetë se disa prej tyre i kishe harruar fare? A nuk t'i risjellin kujtimet sërish në mendje ato foto e letra? Ndoshta mund të gjesh ndonjë histori që nuk e dije. Për shembull, në një letërkëmbim mes gjyshes dhe motrës së saj sheh se ato ishin grindur sepse gjyshja donte të jetonte në një shtet tjetër. Kjo po që është histori interesante!

E GJITHË JETA JOTE

Thjesht mendimi për të shkruar të gjithë historinë e jetës tënde mund të të trembë pak. E para, sepse brenda saj ka kaq shumë gjëra! Ku të fillosh më parë? Të fillosh nga lindja dhe të vazhdosh prej aty, siç veproi Çarls Dickens në librin *David Koperfild*, apo ndoshta të shkruash një seri historik për periudha të ndryshme të jetës tënde, që flasin për ty?

Lista e përmendur më lart mund t'ju ndihmojë me disa ide për këta 'kapituj' të veçuar. Mund të zbulosh se ndërsa fillon shkruan për diçka, të kujtohet diçka tjetër. Lëre këtë të ndodhë dhe bashkë me të lër edhe kujtimet të dalin.

Ose, nuk dëshiron të shkruash një ritregim të ndodhive, por mund të vendosësh të shkruash për diçka që lidhet me mendime e ndjenja të veçanta që keni pasur në një moment të caktuar. Shembuj të këtyre llojeve të temave mund të jenë:

- Një fatkeqësi që kthehet në forcë – historia jote ose e një të afërmi që përballet me diçka të vështirë
- Një romancë e bukur – historia e një dashuriçke apo lidhjeje, ndoshta me momentet e mira e të këqija të saj!
- Një moment krenarie – historia e diçkaje për të cilën je vërtet krenar
- Ëndrrat – çfarë ëndrrash ke pasur kur ishe fëmijë? Çfarë ëndrrash ke tani?

E VULOSUR ME NJË PUTHJE

Nëse do t'i shkruaje letër vetes tënde në moshën 18, 30 ose 45 vjeçare, çfarë do të shkruaje?

Kujto gjërat që ke dashur në atë moshë, dhe se çfarë bëje me jetën tënde. Shkruaji vetes një letër të vërtetë. Tregoji vetes (në moshën që ke zgjedhur) se çfarë pamje ke tani, çfarë të pëlqen të bësh tani, si është jeta tani. Jepi këshilla vetes tënde kur ishe më i ri. Tregoji vetes tënde se çfarë ke mësuar, ose çfarë do të doje të kishe bërë. Mund të çuditesh me gjërat që do të thuash!

STRUKTURIMI I HISTORISË

Pasi të kesh shkruar disa copëza të jetës tënde, mund të zbulosh se të shkruarit është fokusuar në identifikosh strukturën e një historie më të gjatë, nëse dëshiron të shkruash një të tillë. Më poshtë po paraqes disa ide:

- Mund të gjesh pesë pika të rëndësishme për

dashurinë në jetën tënde – shkruaj historinë se si ato lidhen me njëra tjetrën, ose ndoshta se si nuk lidhen fare me njëra tjetrën! Një grup të caktuar ngjarjesh, ose në një ndjenjë apo temë të veçantë. Këto skica shkrimesh dhe historish mund të të ndihmojnë të

- Historia e jetës tënde e shkruar në letra. Ti vendos të shkruash një letër në momentet kryesore të jetës tënde – d.m.th. kur ishe 10, 15, 20, 25, 30 vjeç... Letrat mund t'u drejtohen njerëzve të ndryshëm, por do të flasin me zërin tënd që ke pasur në atë moshë dhe do të shprehin shqetësimet dhe gëzimet që kishe në atë kohë.
- Zgjidh titullin 'Gjërat që kam mësuar' dhe shkruaj historinë e jetës tënde duke u përqendruar te gjërat që ke mësuar – për veten, për botën. Gjysma e dytë e historisë mund të jetë 'Gjërat që nuk kam mësuar'.
- Shkruaj dhjetë bisedat më të rëndësishme që ke zhvilluar në jetën tënde, qofshin të mira apo të këqija. Shkruaji me hollësi, çfarë thatë dhe menduat ti me bashkëbiseduesin gjatë bisedës / grindjes me fjalë / festës / planifikimeve për të ardhmen.
- Gjej dhjetë fotografi që kanë domethënie të madhe për ty dhe që tregojnë një ngjarje të rëndësishme në jetën tënde. Shkruaj për atë që po ndodhte në foto në atë kohë.

E fundit – kënaqu me të shkruarit, kënaqu duke i zbuluar sërish historitë e tua. Brenda teje ndodhet një bibliotekë e tërë. Merr stilolapsin dhe fillo!



Bookbite